



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Istogut**  
Opstina Istok  
Istog Municipality

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

<b>DATË/A:</b>	16.03.2023
<b>REFERENCË:</b>	01/f/2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
<b>CC:</b>	MPB, MAPL, KFOR, OSCE, ICITAP,
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Ilir Ferati, Kryetar
<b>TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:</b>	<b>Ftesë</b>
<b>VENDI/MJESTO/PLACE</b>	<b>Salla e Kuvendit Komunal- Istog</b>

E/I nderuara/i \_\_\_\_\_

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) e cila do të mbahet me datë **23.03.2023** në ora **10.00**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit
3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)
5. E drejta për punë:
  - Puna në sektorin privat
  - Orari i punës
  - Kontratat e punës
6. Abuzimi me fëmijë minorë dhe adoleshent
  - Bullizmi në Shkollë
7. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore
  - Diskriminimi i grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit pranë institucioneve publike
8. Të ndryshme

Pjesëmarrja është e obligueshme për antarët e KKSBB-së.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosova



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

Nr:1	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	23.03.2023 Ora: 10:00
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Kryetari i Komunës: z. Ilir Ferati
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;</li><li>2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;</li><li>3. Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;</li><li>4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,</li><li>5. Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse,</li><li>6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;</li><li>7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;</li><li>8. Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak;</li><li>9. Ganimet Shaqiri, Komuniteti Romë;</li><li>10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;</li><li>11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;</li><li>12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;</li><li>13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;</li><li>14. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;</li><li>15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;</li><li>16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;</li><li>17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;</li><li>18. Blendinela Shatri, EVSB;</li><li>19. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;</li><li>20. Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;</li><li>21. Blendor Isufaj, KVRL;</li><li>22. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";</li><li>23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;</li><li>24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe</li><li>25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.</li></ol>
	<b>Mungojnë:</b> Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi Gjinore

	<p style="text-align: center;">Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë</p> <p><b>Pjesëmarrës tjerë:</b>  Ali M. Krasniqi, inspektor i Punës  Ardita Lubeniqi, Sherbimi Sprovues i Kosovës, Pejë  Blerim Gerguri, përkthyes,  Atdhe Fetahu, RTV Fontana,  Abetare Sutaj, RTV Fontana,  Jeta Balaj, Komuna Istog  Ardn Arifaj, Komuna Istog</p>
<p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i Rendit të ditës,</li> <li>2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit,</li> <li>3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK -së</li> <li>4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqses të komuniteteve etj.)</li> <li>5. E drejta për punë: <ul style="list-style-type: none"> <li>-Puna në sektorin privat</li> <li>-Orari i punës</li> <li>-Kontratat e punës</li> </ul> </li> <li>6. Abuzimi me fëmij minorë dhe adoleshent <ul style="list-style-type: none"> <li>-Bullizmi në Shkolla</li> </ul> </li> <li>7. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore <ul style="list-style-type: none"> <li>Diskriminimi i grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit pranëinstitucioneve publike</li> </ul> </li> <li>8. Të ndryshme</li> </ol>	

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - I njoftoj anëtarët e KKSB-së që Kryetari z. Ilir Ferati është në një takim të pa planifikuar dhe me lejen e tij mund të fillojm me mbledhjen dhe në nderkoh do të na bashkangjitet Kryetari. Përshëndet të pranishmit dhe anëtarët e KKSB-së. Përshendet inspektorin e punës dhe përfaqsesen e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Para se ta hudhi në votim rendin e dites më lejoni të theksoj se Vetëm Servete Haxhijaj ka lajmruar për mospjesmarrje në mbledhje me arsyetim, ndersa të tjerët nuk kanë lajmruar. Konstatoj se nga 24 anëtar të KKSB-së, prezent janë 21 anëtar, anëdaj kemi kuorum për mbledhje. Me që zyrtarja Servete Haxhujaj mungon me arsye propozoj që pika e shtatë e rendit të ditës të shtyhet për takimin e radhës. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rëndit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e Koordinatorit të KKS-së.

## 2. Miratimi i procesverbalit nga Mbledhja e kaluar

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - Pyeti antaret e KKS-së a ka dikush vrejte në procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Me që nuk pati vrejte, Koordinatori pyeti kush është për miratimin e procesverbalit. Gjithë antarët e pranishëm të KKS-së votuan për miratimin e procesverbalit.

## 3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policis.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog** - Gjendja në zonën e përgjegjesis së stacionit Istog është e qetë, stabile e qendrueshme. Nga një janari deri në këtë moment raportimi para jushë, kemi pasur gjithsejtë 144 raste të ndryshme: 20 aksidente, nga të cilat një vetëaksident me fatalitet në rrugën Istog-Vrellë. Në fund të këtij muaji për tremujorin e parë do të vij me një raport më të detajuar. Nese keni pyetje jamë i gatëshëm të pergjigjem.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - E falenderoj komandantin dhe pyet anëtarët a kanë pyetje për komandantin e Policisë lidhur me Sigurinë në zonën e Përgjegjesis. Me që nuk ka kalojm në piken e radhes të rendit të ditës.

## 4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqses të komuniteteve etj.)

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - Me që perfaqsesit e KFOR-it nuk janë të pranishëm pyet perfaqsesit e FSK-së dhe institucioneve tjera a kanë ndonjë çeshtje për ta diskutuar.

**N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;** Ju informoj që FSK-ja është duke i zhvilluar aktivitetet sipas Planit. Një Ushtrim fushor është i planifikuar të filloj nga data 18 prillë por deri atëher besoj se do të kemi takime me akter të siguris e në veçanti me Komunën e Gjakovës ku do të mbahet ushtrimi së bashku me akter ndërkombëtar.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - E falenderoj komandantin për informimin dhe pyet për bashkpunimin me Shkollën. Me që Komandantit të Forcave Toksore ju ka parashtrua një kërkesë për huazim të disa uniformave dhe prezencës së FSK-së në ditën e Shkollës së "Hysni Zajmi" Vrellë, në të cilën komanda ka dhanë përgjigje negative, mendoj që FSK-së i bën nder të jetë prezent në mesin e nxënësve dhe uniforma e FSK-së të mishrohet me nxënës nga të cilet mund të kemi pjestar të ardhshëm të FSK-së.

**N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK-** kërkoj që në të ardhmën gjitha kërkesat ndaj FSK-së për bashkëpunim civilishtarak të drejtohet përmes njësis tonë, sepse ne e dimë kujt (cilës njësi) duhet ti procesohet kërkesa. Emailadresen time e keni të gjithë anëtarët e KKSB-së, gjegjësisht Shkollat.

**Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas -** Pershendet të pranishmit, kamë pyetje lidhur me vërshimet e nëntorit dhe janarit, a është kompenzuar dikush në ekonomin familjare dhe në bujqësi.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave -** Falenderoj Ukën, komisioni permanent ka kryer vlersimet në bashkëpunim me komisionet adhoc , për janar janë 122 raste në bujqësi dhe 79 raste në ekonomi familjare si dhe infrastruktur, biznese, Shkolla dhe objekte kolektive me vler totale prej 2.585.511€. Materiali është dorëzuar komisionit qendror së bashku me formularët e unifikuar me konfirmime bankare do të dorëzohen brenda javës. Premtimi nga Kryeministri është se do të kompenzohen dëmet e krijuara nga vërshimet. Komisioni qendror do ti procesoj vlersimet e nëntorit dhe të janarit. Nuk kemi informata a do të kompenzohen 100% vlerën e damit ng komisioni apo mvarsisht nga mjetet që i ndan Qeveria ndonjë përqindje.

**Blendor Isufaj, KVRL-** I kamë dy pyetje për drejtorin e Arsimit. Shqetsimin e studentve që falenderohen për dyfishimin e bursave por pyetja është kur do të ekzekutohen këto bursa dhe e dyta a ka mundsi të bëj diçka për transportin e studentve, gjegjësisht për çmimin e biletave me që çmimi i naftes ka zbrit ndersa vlera e biletës ka mbet e njëjt dhe Istogu është me çmimet më të larta në Kosovë.

**Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim -** pershendes të pranishmit dhe shfrytëzoj rastin tju uroj muajin e Ramazanit dhe ju deshiroj agjerim të lehtë. Sa ju perket bursave jemi duke u munduar që brenda këtyre dy muajve ta kryejm pagesën e plot vjetore e jo ta ndajm në dy pjes sikur ka qën ma heret. Sa ju perket çmimeve të biletave të transportit pajtohëm që çmimi është i lartë por ne si drejtori nuk kemi çasje me që janë linja të kompanive private, e vetmja mënyr është që Drejtorati i Sherbimeve Publike në koordinim me pronaret e kompanive të debatojn dhe të arrijn një zgjidhje. Ju faleminderit.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave -** Me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pik kalojm në pikën e pestë të rendit të ditës.

#### **5. E drejta për punë:**

- Puna në sektorin privat
- Orari i punës
- Kontratat e punës

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave -** ftoj Inspektorin e punës z. Ali Krasniqi ta paraqes një raportin nga inspektimet e kryera në Komunën e Istogut.

**Ali Krasniqi, Inspektor i punës-** I pershendet të prënishmit, e drejta për punë është e garantuar me Kushtetutë, gjegjësisht me Ligjin e Punës 03-L-2012, i cili percakton të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve në sektorin publik dhe privat. Mbi 70% e punëmarrësve janë të punësuar në sektorin privat. Si shqetsim ju i keni cekë kontratat e punës dhe orarin e punës. Në shumicën e rasteve kontratat e punës nuk rrespektohen. Puna më e gjatë se orari lejohet vetëm në raste emergjente në kohë të shkurt në të kundërt nuk lejohet. Nga inspektimet në komunën e Istogut kemi gjetë shkelje si në vijim, puna më e gjatë se orari i punës, mosrrespektimi i pushimeve vjetore. Një raport e kemi derguar në tetor, ku janë paraqit subjektet e inspektuara të cilat edhe janë gjobit për shkeljet e gjetura. Puna jashtë orarit është punë vullnetare në marrveshje punëdhënës-punëmarrës, e cila duhet të kompenzohet për punën e kryer jashtë orarit të punës. Për fillim kamë kaq nese ka pyetje jamë i gatshëm të pergjigjem.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave -** E falenderoj inspektorin Krasniqi, në pergatitjen e mbledhjeve, paraprakisht i dergoj njoftimet për kohën e parapar për mbledhje dhe temat e diskutimit ashtu si e kam bër edhe në rastin e juaj në tetor. Nga ju kamë pranuar konfirmimin se do ti kryejni inspektimet pikrisht në temat e cekura në Planë dhe do të jeni i gatshëm për paraqitjen e një raporti. Megjithatë në datën e mbledhjes ju e keni derguar një raport në email timin dhe nuk keni qen prezent, andaj unë në mbledhje i kamë njoftuar antarët e KKS-së ku është marr vendim të shtyhet kjo temë për mbledhjen e radhës me që nuk mund të hapim debat. Pas konsultimeve të mia edhe me Kryeinspektorin ju sotë jeni prezent dhe do të ishte mirë ti njoftoni antarët edhe me atë raport. Sidoqoft nga tetori ka kaluar një kohë dhe Inspektorati pas inspektimeve ku has në shkelje e jep një kohë për permirsim të gjendjes dhe pason riinspektimi për të par a janë evituar mangsit, andaj më intereson a keni kryer riinspektive në marketet ku keni has shkelje dhe cila është gjëndja.

Në nderkoh Kryetarin Ilir Ferati Feratine njoftova me ecurin e deritanishme të mbledhjes dhe ja kaloj udhëheqjen e mbledhjes.

**Ali Krasniqi, Inspektor i punës-** Po në riinspektimet kemi vrejtur se ka permirsime sa i perket orarit të punës, ndersa sa i perket pushimeve vjetore duhet ta konstatojm në inspektimet në vijim ku do të shohim efektin e gjobave, me që jemi në fillim të vitit dhe këtë vrejtje nuk kemi mundur ta konstatojm tani.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit-** pershendet të pranishmit dhe kerkon falje për vonesen për arsye të një takimi të pa planifikuar dhe hapi debatin lidhur me raportin e paraqitur dhe pyetjet që kanë antarët lidhur me temen.

**Blendor Isufaj, KVRL-** Nuk e di sa lidhet pyetja ime me Inspektorin apo tjetër resurs, por shqetsimi i disa punëdhënësve dhe punëmarrësve është me që në disa komuna tani më dita e diell është ditë pushimi e rregulluar me rregullore, andaj pyetja ime a ka mundësi që kjo të rregullohet edhe në Komunën tonë.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit-** këtë çeshtje e kemi diskutu edhe ne në bashkpunim me bizneset që kanë numrin më të madhë të të punësuarve, këtë temë duhet ta

rregullojmë përmes plotsim ndryshimit të Rregullores, e kemi debatuar edhe në Drejtorinë e Zhvillimit ekonomik, jamë në dijeni që Komuna e Pejes e ka bërë por nuk jamë në dijeni sa është duke u zbatuar.

**Blendor Isufaj, KVRL-** Komuna e Pejes e ka anuluar serish.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit-** e ka anuluar për arsye të mos zbatimit, andaj ne jemi të interesuar ta analizojmë dhe të bëjmë një zgjidhje të mundshme por jo nxierrim vendim apo Rregullore vetëm si fasad, pra kur të marrim një konfirmim nga bizneset do të bëjmë një gjë të tillë sepse këtu jemi tju shërbejmë gjithë qytetarëve.

**Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas -** Pyetje për Inspektorin, në kontratë a i shkruhet punëtorit sa orë ka me punë sepse në shumë vende punëtorët punojnë nga 12 orë.

**Ali Krasniqi, Inspektor i punës-** Në kontratë theksohet orari i punës, theksohet orari shtesë dhe orët jashtë orarit, vikende festa etj dhe obligimet e punëdhënësit, andaj punëmarrsit i mbetet që të kërkojë të zbatohet kontrata.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** përshendes Ktyetarin dhe të prënishmit, lidhur me temën mund shtrohen shumë pyetje, nga raporti i inspektorit po shifet se egziston një arbitraritet i punëdhënësit si dhe pushimet vjetore. Pyetja ime është lidhur me të drejtat e punëtorit, a ka të drejtë punëdhënësi ta largojë nga puna punëtorin kur tja dojë qefi atij apo ka të drejtë puntori në këtë kontekst dhe pyetja e dytë a ka ndonjë rast kur inspektorët kanë kërkesa nga punëtorët sidomos në sektorin privat, sepse mund të vijë edhe të vdekja e punëtorit në vendin e punës në veçanti në sektorin e ndertimit, cilat janë të drejtat e punëmarrsit apo familjes nëse ndodhë e që në mjetet e informimit ndegjojmë që ka pas raste. Besoj se kamë qënë i qartë në pyetjet.

**Ali Krasniqi, Inspektor i punës-** Ligji e përcakton qartë edhe shkëputjen e mardhanjës së punës, andaj nuk ka mundësi punëdhënësi të shkëpusë mardhanjën e punës kur të teket. Punëdhënësi mund ta largojë nga puna punëtorin për shkelje të rënda pa paralajmërim. Në të kundërtën punëdhënësi është i obliguar që 30 ditë ta paralajmërojë punëtorin për shkëputje të mardhanjës së punës.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** pyetje shtesë, kjo është sipas Ligjit por a rrespektohet në realitet ky faktë.

**Ali Krasniqi, Inspektor i punës-** për mos rrespektim të këtij Ligji në rast ankesave punëdhënësit ndeshkohen. Për pjesën e dytë të pyetjes a ka ankesa nga punëtorët. Po ka ankesa, inspektori është i detyruar të shqyrtojë ankesat dhe brenda afatit Ligjor prej 30 ditëve detyrohet të kthejë përgjigje parashtruesit të ankesës. Tek pjesa e pyetjes për lëndime në vendin e punës, në vitin paraprak janë 14 raste të humbjes së jetës në nivel vendi. Inspektori i punës bën raport nga vendi i ngjarjes për rrethanat e lëndimit-humbje jete dhe nxierr Vendim, gjoha e shqiptuar nga Inspektori shkonë në thesarin e shtetit, ndërsa të drejtat për kompensim dëmi (lëndim apo humbje jete) pala e dëmtuar i realizon përmes Gjykatës.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit-** I nderuar Inspektor Krasniqi, tek orari i punës dhe kontratat e punës në sektorin privat, kemi shumë ankesa nga qytetarët, unë personalisht dhe ekzekutivi, jemi të vetëdijshëm çka percakton Ligji, por jemi në dijeni që ka shkelje të Ligjit nga punëdhënsit. Prezenca e Inspektorve të punës në komunën e Istogut është e vogël, ka shumë raste kur lehonat largohen nga puna vetëm pse punëdhënsi nuk e rrespekton Ligjin dhe tja paguaj pushimin e lehonis andaj e largon nga puna dhe shumë raste të tjera. Ligji është i mirë por zbatimi i Ligjit është jashtëzakonisht keq dhe mendoj se duhet ti kushtohet rëndsi të madhe sepse perpos që e zvoglon informitetin e rrit formalitetin dhe sigurin në familje. Nuk kemi mundsi që gjithë qytetarit të punësohen në institucione, andaj një nga arsytet pse rinija po largohet nga Kosova është edhe kjo dukuri, pra mos rrespektimi i Ligjit të punës nga punëdhënsi, pa siguria e punëtorit në vendin e punës, pason zhgenjimi në institucione dhe zgjidhja është ambasada , gjegjësisht largimi në vendet evropiane. Nga kjo pasojn rënja fuqis ekonomike, zvoglimi i buxhetit dhe mbesim pa punë edhe unë dhe ti.

**Ali Krasniqi, Inspektor i punës-** po nisem nga pyetja e fundit nuk i kam nxierr statistikave por një gjë të tillë mund ta bëj dhe tju njoftoj përmes koordinatorit. Sa i përket prezencës së inspektorve, deri në nëntor kemi qenë me vetëm dy inspektor për krejt regjionin, tani i kemi edhe tre inspektor. Komuna e Istogut trajtohet barabart me komunat tjera, është normale se Peja është qytet më i madh dhe jemi prezent më shumë. Mirëpo edhe në Istog i kemi inspektuar të gjitha fushat, mund të them që në Istog popullata është më e kulturuar dhe kanë rrespekt për institucionin.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit-** e falenderoj Inspektorin, pyet a ka diskutues tjer lidhur me këtë temë, me që nuk ka diskutues tjer kalojm në pikën e 6 të rëndi të ditës.

## **6. Abuzimi me fëmijë minorë dhe adoleshent -Bullizmi në Shkollë**

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit -** fjalën ja kaloj Drejtorit të Arsimit, për një informatë

**Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim -** Sa i përket bullizimit në Shkollë problemi më i madh na paraqitet me rastin e ardhjes së nxënësve nga paralelet e ndara në Shkollën amë. Megjithatë Drejtoret e Shkollave kanë ndermarrë masa dhe gjëndja është në përmirësim dhe sipër. Përveç rastit të cekur kemi bullizim edhe në rrjetet sociale e që fatkeqsisht nga njëherë kjo i tejkalon edhe nivelin e bullizimit duke kaluar edhe në perleshje fizike. Megjithatë puna e Drejtorve e Psikologve në Shkollë përmes ligjeratave duke përdorur edhe video inçizime kjo dukuri është nën kontroll në drejtim të zhdukjes. Sa i përket sigurisë në Shkollë duke falenderuar komandantin e Policisë si dhe Policin në përgjithësi gjëndja e sigurisë edhe pse me incidente të vogla është në nivel të duhur me përmirësim në baza ditore. Kontaktet janë të vazhdueshme Polici - Drejtor Shkollë - Psikolog duke analizuar rastet dhe duke ndermarrë masa andaj sipas raporteve të dorëzuara nga psikologët Bullizimi është në rënje dhe sipër, pra Psikologët në vazhdimësi mbajnë ligjerata kundër bullizimit por në veçanti vazhdojnë me kontakte

dhe biseda me nxënësit e bullizuar për ti tejkaluar problemet të cilat kanë mundur tu shkaktohen nga bullizmi. Ju faleminderit jamë i gatshëm për pyetjet e juaja.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - e falenderon Drejtorin e DKA-së, para se të hap debatin fjalën ja kaloj Ardita Lubeniqi nga ShSK për një raport për abuzimet me fëmijë minor dhe adoleshent e më pastaj e hapim debatin.

Ardita Lubeniqi, Sherbimi Sprovues i Kosovës (ShSK) - përshendet të pranishmit, për informimin tuaj ShSK është agjensi ekzekutive që sherben në kuader të Ministris së Drejtësisë, kryesisht merret me të mitur të cilët kanë rënë në ndesh me Ligjin. Qëllimi është riedukimi dhe risocializimi i të miturve që kanë rënë ndesh me Ligjin. Sipas statistikave që ne i posedojmë gjatë vitit 2022 nga Komuna e Istogut i kemi 33 raste dhe kryesisht janë si pasojë e lëndimeve të lehta trupore si pasojë ashtu si edhe e ceku Drejtori i DKA-së Bullizmi dhe atë nxënës-nxënës; nxënës -mësimdhënës dhe anasielltas. Shpresoj që kjo dukuri të zhduket ashtu si e potencoj Drejtori i DKA-së përmes vetëdijesimit nga ana e Drejtorve dhe Psikologëve të Shkollave dhe shoqëria në përgjithësi. Është shqetsuese se statistika e vitit 2023 nga janari deri me 20 mars nga Komuna e Istogut janë 31 raste dhe krahasimi me vitin 2022 ku kemi gjithsej gjatë gjithë vitit 33 raste, këtë vit pa u mbush tre muaj kemi 31 raste duke përfshirë edhe vepra penale, lëndime trupore, ngacmime dhe përdorues të narkotikëve. Ky fakt mund të jetë pak alarmant andaj shfrytëzoj rastin tuaj bëj thirrje të gjithë akterve për ndermarrjen e masave që ti parandalojmë adoleshentët të vijnë në kundërshtim me Ligjin. Ju faleminderit.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - e falenderoj znj. Lubeniqi dhe hapi diskutimin lidhur me dy raportet e paraqitura.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar** - Fenomeni i bullizmit në të kaluarën nuk është trajtuar në masë të duhur në procesin arsimor. Efektet e tij sipërfaqsisht duken se nuk kanë pasojë, por nëse e analizojmë në psikikën e të miturve-adoleshentëve e krijojmë një traumë dhe si pasojë sjellë konfliktin mes akterve ose tek depresioni ndaj atyre që ushtrohet bullizmi. Drejtori na dha një pasqyrë kohe optimiste, por unë mendoj se aji është bazuar vetëm në raportet që i kanë sjellë psikologët e Shkollave. Mendoj se këto raporte do të duhet të shiqohen edhe nga këndi kritik me qëllim që egziston mundësia që nga psikologët e shkollave pakëz të hujdisen. Lufta ndaj bullizmit nuk është edhe aq e lehtë, burimin e ka tek mos edukata dhe shpirti i ligë apo i ngushtë e disa personave. Kamë pershtypjen se duhet të kushtohet vëmendje më e theksuar, sidomos nëse ushtrohet në baza gjinore, racore apo etnike apo pamja e jashtme tek personat me nevojë të veçanta. Nëse Drejtori ka ndonjë përgjigje më të specifikuar do të ishte mirë për shqetsimet që i ngrita.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - faleminderit Profesor, nga përvoja tuaj në arsim a keni ndonjë këshill për ne si ekzekutiv, është e mirë se keni dëgjuar.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar** - DKA-ja duhet ta ketë në agjendë vjetore dhe përmes mekanizmave të vetë të bëjë vlerësimet por jo të bazohet vetëm nga raportet e

Shkollave gjegjësisht psikologëve, me qe kemi prirje duke u nisur nga rruga më e lehtë të bëjm vlersimin çdo gjë është në rregull. Më pelqeu fakti se mbahen ligjerata për këtë fenomen, por do të duhej të jetë një vlersim në form pyetsori për efektin e ligjeratave por edhe të bëhet një vlersim i vetë materialit të pergatitur për ligjerat dhe përfshirja e kujdestarve të klasës shtu si e potencoj znj. Lubeniqi, që nxënsit haptas të debatojn për mënyren dhe metodat e shfaqjes së bullizmit. Ky do të ishte një opsion i imi.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - Faleminderit Profesor, pa diskutim që është në agjenden e DKA-së dhe e jona si ekzekutivsepe tek e fundit janë fëmijt dhe e ardhmja jonë dhe nuk duhet lejuar që fëmija të rritet me një defekt psikologjik shkaku i një pakujdesije që e kemi pas ne në një moment të veçant. Kemi projekte edhe me Policin e Kosovës edhe në identifikim të rasteve dhe në aktivitetet e më vonshme të këtij fenomeni. Përpos kësaj mendoj se do të duhej ti kushtojm rëndsi të veçant edhe si shoqëri në pergjithësi, mos të mbetet vetëm si detyr zyrtare e zyrtarve të lidhur drejtëpërdrejt me arsimin. Një kontribut këtu mund ta japin edhe klerikët fetar permes paraqitjeve të tyre në objekte fetare apo raste tjera në shoqri.

**Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave** - Me Planin e punës të KKSB-së në piken 3 është e parapar bashkëpunimi KKSB-DKA-Shkolla lidhur me temen dhuna në Shkolla, psiqike, fizikeetj ku nderlidhet edhe kjo temë që sa po trajtuam andaj propozoj që ta emrojmë një ekip ku do të bëjn pjes Profesori Zenun Bujupaj, pervoja e të cilit do të na ndihmoj shumë, Skenderi si Kordinator i KKSB-së, Blendineta nga EVSB-, Blendori nga KVRL, nga një perfaqshues i DKA-së dhe PK-së të cilet do ta bëjn një vizit shkollave sikurse vitin e kaluar ku do të trajtohen këto tema, gjegjësisht analizat e Këshillit drejtues dhe këshillit të nxënësve, a i kan bër analizat dhe vlersimet dhe më pastaj ky ekip do të njoftoj KKSB-në me propozime.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - pajtohem me propozimin e Skenderit dhe pyet antarët kush është për këtë propozim. Konstatohet se antarët në mënyr unanime ianë për këtë propozim dhe antarët e ekipit.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog** -deshta të theksoj se PK-ja vite me radhë në bashkëpunim me DKA-në vite me radhë ligjerojm në gjitha shkollat e Istogut lidhur me temat Bullizmi, Drogat, Komunikacionit dhe tema të ndryshme. Ka rezultate të dukshme në këtë aspekt.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - me që nuk ka debatues të tjer lidhur me këtë pikë, ather kalojm në piken e radhës të ndryshme.

## 8. Të ndryshme

**Enver Boletini, KLSP-Gurakoc** - Tanimë disa herë në këto mbledhje e kamë ngrit shqetsimin e komunitetit lidhur me sigurin në komunikacion në afersi të Shkollës në Veriq. Jeni në dijeni se tashëmë qe disa raste ka pas aksidente dhe lendime trupore duke përfshi edhe me fatalitet të nxënësve të Shkollës. Kerkesa jonë ka qën për

vendosjen e pengesave në afersi të Shkollës. A ka mundsi të kemi një përgjigje a është ndermarr diçka në këtë drejtim.

**Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit** - Po Enver është shqetsim edhe i joni, por si rruga në afersi të bajës si tek udhëkryqi Istog Rakosh në Bellopoj poashtu dhe rruga tek Shkolla e Veriqit janë kompetenc e Ministris dhe me shumë veshtersi duke bër presion të vazhdushem është ndermarr disa gjëra edhe në këto vënde. Ne do ta perserisim kërkesën në bashkëpunim me Komandantin e Policis në Ministri, gjegjësisht në departamentin e rrugëve.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog** - pajtohem me kryetarin jemi në dijeni me këtë problem dhe do ta perserisim kërkesën.  
Mirupafshim në takimet e radhes.

**Mbledhja perfundoj:**

11.20